

VENDIM
Nr.558, datë 19.7.2007

**PËR SHPALLJEN E GJENDJES SE EMERGJENCËS NË DISA QARQE TË VENDIT, PËR
SHKAK TË ZJARREVE MASIVE NË PYJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, dhe të neneve 36 e 37 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile për shkak të zjarreve në pyje, në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe Lezhë, duke filluar nga data 24.7.2007.

2. Krijimin e Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, të kryesuar nga zëvendëskryeministri.

3. Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile të ketë në përbërje Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe zëvendësministrin e Brendshëm.

4. Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet ekzistuese shtetërore dhe të marrë me qira, kur nuk disponon, mjete, në mënyrë që situata në pyje të vihet nën kontroll, në një kohë sa më të shkurtër.

5. Ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore të vënë në dispozicion të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile të gjitha burimet, që kanë.

6. Prefektët e qarqeve të ngrenë komisionet e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave, për menaxhimin e situatës së krijuar.

7. Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile ta njoftojë, çdo ditë, Kryeministrin për situatën dhe punën e bërë në shuarjen e zjarreve në pyje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha